

Data 13.03.2022.

## **Deklaratë**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi është njohur me informacionin e publikuar në mediat serioze dhe ato të portaleve të tjera online, nuk mbështet aspak lajmet e rremë të dala në rrugë jozyrtare të cilat qëllimisht kanë si synim, të disinformojnë publikun dhe të cenojnë besimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

Përgënjeshtrojmë lajmin se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore është lenë i lirë shtetasi Helidon Gjikota, pasi nuk është informacion i vërtetë.

**Dje, në datë 12.03.2022** nga ana e Gjyqtarit Enkel Peza, në zbatim të neneve 228, 229, 238, 248 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, është vendosur me vendim e datës 12.03.2022 për vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”, për të pandehurin Helidon Gjikota.

Lajme të tilla jo të vërteta shkelin parimet e drejtësisë, duke denigruar figurën e magistratëve dhe gjykates, cenojnë magistratët në dhënien e drejtësisë dhe besimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

Ftojme mediat dhe portalet serioze të përgënjeshtojnë lajmin dhe të mos bien “pre” e informacioneve qëllimisht të rreme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka qenë dhe do vazhdoje të jetë e hapur ndaj cdo gazetari, media, apo institucione të tjera, në dhënien e informacionit zyrtar dhe të vërtetë, sikurse kemi qenë transparent për cdo vendim të dhënë nga gjykata jone, të kërkuar nga media apo subjekte të tjera të interesuara, të cilat kanë përbërë interes publik.